




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPKI	Nr. Prot. 06-02/2651/22
Dep. DPKI	Br. Prot. 06-02/2651/22
Nr. i faq. 02	Data 23.06.2022
Broj stranic 02	Datum 23.06.2022
Nr. pages	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 22.06.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-1071/22, për zyrtarin z. Isa Duka, Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Isa Dukaj, zv. Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia kundër Korrupsionit, pas pranimit të informatës nga raportuesi anonim, ka filluar trajtimin e këtij rasti me pretendimin për konflikt të interesit nga z. Dukaj, pasi që i njëjti ka formuar një komision dhe kryetar të komisionit ka emëruar vetën e vet për t'ia rekomanduar vetës së vet shpalljen e pavlefshëm të vendimit si dhe vendimin e ka nënshkruar vet.

Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.



Pas kësaj, Agjencia ka kontaktuar me zyrtarin në fjalë, me ç'rast e ka njoftuar me pretendimet lidhur me situatën e mundshme të konfliktit të interesit si dhe me faktet që posedon Agjencia, si dhe me të njëjtin ka caktuar edhe takim në Agjenci.

Në takimin e mbajtur, z. Duka ka sqaruar se, komisionin këshillues/rekomandues ad-hoc e ka krijuar bazuar në praktikë të mëparshme në Agjenci për komisione ad-hoc, dhe atë me qëllim të nxjerrjes së një vendimi meritor dhe profesional lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së një kërkesë, arsyeshmërin e kërkesës si dhe bazon ligjore për aprovimin apo refuzimin e kërkesës. Gjithashtu z. Dukaj ka sqaruar se anëtarët e komisionit në fjalë nuk kompensohen për punë e tyre në komision, kurse sipas ligjit vendimin përfundimtar kam të drejt ta nxjerr edhe pa formimin e komisionit. Të njëjtat sqarime z. Dukaj i ka dërguar në Agjenci kundër Korrupsionit edhe përmes shkresës DPKI-06-2592/22.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës si dhe sqarimeve nga pala, Agjencia ka gjetur se rasti në fjalë ka të bëjë me procedurat e brendshme të Agjencisë për Pronësi Industriale dhe se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për konflikt të interesit ashtu siç përcakton Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, respektivisht: *"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare."*

Gjithashtu, në bazë të shkresave të lëndës që posedon Agjencia, nuk është gjetur se z. Dukaj ka pasur interes privat me rastin e formimit të komisionit në fjalë si dhe nxjerrjes së vendimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit se:

"Interes privat i personit zyrtar – nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste."

Ky vendim i referohet rastit të z. Dukaj, ndërlidhur me Vendimin Nr.14/1892 dhe Rekomandimin Nr. 14/1902, në të cilat i njëjti ka marrë pjesë dhe nuk trajton çështje tjera e as nuk mund të merret si precedent për rastet tjera. Vendimet e Agjencisë për Pronësi Industriale, duhet të nxirren konform dispozitave ligjore përkatëse me të cilat funksionon e njëjta, duke shmangur çdo dyshim të mundshëm për konflikt të interesit me rastin e vendimmarrjes.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

